



**REPUBILKA E SHQIPERISE**  
**-AUTORITETI I KONKURENCES-**

---

**NJOFTIM PËR SHTYP**

**Mbi Vendimin nr. 374, datë 09.10.2015 të Komisionit të Konkurrencës**

**“Për miratimin e Udhëzimit “Për kushtet dhe detyrimet në rastet  
e përqëndrimeve””**

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 374, datë 08.10.2015, miratoi Udhëzimin “Për kushtet dhe detyrimet në rastet e përqëndrimeve”, i cili është hartuar duke përkthyer, përshtatur dhe përafuar njoftimin e Komisionit Europian mbi masat e pranueshme sipas Rregullores së Këshillit nr. 139/2004 dhe sipas Rregullores së Komisionit nr 802/2004 (52008XC1022(01)), (OJ C 267, 22.10.2008, p.1-27). Ky udhëzim synon plotësimin e kuadrit ligjor dytësor në fushën e konkurrencës, në respektim dhe në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) , si dhe në kuadër të plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar për Integrimin Europian.

Qëllimi i Udhëzimit është përcaktimi i rregullave dhe masave mbi angazhimet që marrin përsipër ndërmarrjet që janë të interesuara, për ndryshimin dhe autorizimin e përqendrimit.

Masat (*Remedies*) janë ndryshimet/modifikimet që i bëhen një përqendrimi, të propozuara nga palët në një përqendrim me synimin për të eliminuar problematikat dhe shqetësimet e konkurrencës, të cilat janë identifikuar nga Autoriteti i Konkurrencës në një procedurë të kontrollit të përqëndrimeve.

Palët pjesëmarrëse në një përqendrim, lejohen që të ndryshojnë përqendrimin, i cili krijon dhe sjell shqetësime për konkurrencën, me qëllim marrjen e autorizimit nga Komisioni.

Element kryesor është parimi i proporcionalitetit të masave. Autoriteti i Konkurrencës vlerëson nëse një përqendrim është i pajtueshëm me tregun apo jo dhe është përgjegjësi e palëve ofrimi i propozimeve të përshtatshme për eliminimin e problematikave të konkurrencës. Nëse palët dështojnë në ofrimin e këtyre masave, atëherë Komisioni merr vendim për ndalimin e përqendrimit.

Draft udhëzimi u diskutua brenda Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës si dhe iu është dërguar për mendim palëve të treta të interesuara si dhe studiove ligjore. Gjithashtu, në respektim të parimit të transparencës, draft udhëzimi është publikuar edhe në faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës për tërheqje mendimesh dhe komente.